



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:135408

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04977981

P.nr.1970/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale ndaj të akuzuarve S. J. nga O., i akuzuar për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë neni 321 par 3 të KPRK-së, dhe i akuzuari M. B. nga O. për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 3 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2700/20 të datës 15.10.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 16.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi dhe të akuzuarve S. J. dhe M. B., me datë 21.11.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 27.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- S. J., i biri i S. dhe nëna Zh., e gjinisë B., i lindur me ..., në M., me vendbanim fshatin P. K. e O., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, e gjendjes së dobët ekonomike, Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.
- M. B., i biri i Ll. dhe nëna B., e gjinisë M., e lindur me ..., në P., me vendbanim në fshatin P. K. e O., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, e gjendjes së dobët ekonomike, Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

Me datën 23.04.2020, në orët e vona të mbrëmjes, në fshatin P., K. e O., i pandehuri S. J., me dashje, me një xham të shishes së birrës e ka dëmtuar ceradën e sallës ballon, e cila sallë shërben për përdorim publik, me çka të dëmtuarës K. së O. i ka shkaktuar dëm material.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë neni 321 par 3 të KPRK-së.*

Me datë, kohë dhe vend të njëjtë i pandehuri M. B., me dashje ka ndihmuar të pandehurin S. J., në kryerjen e veprës penale si në dispozitivin e parë në atë mënyrë që i pandehuri M., ka bërë

roje derisa i pandehuri S. me dashje me një xham të shishes së birrës e ka dëmtuar ceradën e sallës ballon, e cila shërben për përdorim publik, pronë e K. së O.

- *Me këtë ka kryer Ndhmë në kryerjen e veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 3 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve , 7, 8, 9, 10, 17, 21, 33, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72 dhe 321 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i gjykon me:

DËNIM ME BURGIM DHE GJOBË

- I.** Të pandehurin S. J., për veprën penale nga pika I e dispozitivit, i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej 100.00 (njëqind) Euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej prej 30 (tridhjet) dite i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në vlerë prej 200.00 Euro (dyqind) Euro, ashtu që dënimin me gjobë në shumën e përgjithshme prej 300.00 (treqind) Euro i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Të pandehurit M. B., për veprën penale nga pika II e dispozitivit, i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro, të cilin dënimin i pandehuri obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- III.** Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata konform nenit 43 par 3 të KPRK-së do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.
- IV.** Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj secili veç e veç shumën prej nga 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- V.** Pala e dëmtuar K. e O., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet që ta realizon në procedurë të rregullt civilo-juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.2700/20 të datës 15.10.2020, ndaj të akuzuarve S. J. nga O., i akuzuar për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë neni 321 par 3 të KPRK-së, dhe i akuzuari M. B. nga O. për shkak të veprës penale Ndhmë në kryerjen e veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 3 lidhur me nenin 33 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.11.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, të akuzuarve S. J. dhe M. B., ku të akuzuarit pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e kanë pranuar fajësinë për veprat penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë neni 321 par 3 të KPRK-së, dhe Ndhmë në kryerjen e veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 3 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, i kanë

premtuar Gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëritin një veprime të tilla dhe se ndjejnë keqardhje.

Pas deklarimit të akuzuarve, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë.

Gjykata konstatoj se të akuzuarit e pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të akuzuarit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat janë njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2020-AJ-0149, i datës 23.04.2020; Raporti i Policit S. V. #..., i datës 24.04.2020; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin S. J., i datës 07.05.2020 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin M. B., i datës 07.05.2020 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin V. J., i datës 26.04.2020 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq; Procesverbali i marrjes në pyetje për ankuesin L. J., i datës 24.04.2020 dhënë në Stacionin Policor në Obiliq, si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitivin të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit S. J. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë neni 321 par 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074) dhe për të pandehurin M. B. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 3 lidhur me nenin 33 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin. Gjithashtu të akuzuarit kanë treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe duke shprehur keqardhje për veprën që e kanë kryer dhe kërkim faljen e tij. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarve. Ndërsa si rrethanë rënduese ishte fakti se të akuzuarit kanë kryer këtë veprë penale me dashje.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 42 dhe 43 të KPRK-se të akuzuarit i gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Gjykata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoj në kontest civil për realizimin e kërkesës së saj pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1970/20 më datë 27.11.2023

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.